


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më 18.6.2026
Nr. 1532

Lënda: Për mbledhjen e Komisionit Rregullator, për shqyrtimin e projektaktit “Për disa shtesa në vendimin nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, ‘Për miratimin e Rregullores për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit Ankimeve dhe Sanksioneve”, i ndryshuar.

Drejtuar: Z. Ilirjan Celibashi
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Komisionit Rregullator

I nderuar z. Komisioner,

Të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator,

Me vendimin nr.3, datë 06.11.2020, Komisioni Rregullator, ka miratuar Rregulloren për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit Ankimeve dhe Sanksioneve.

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e akteve normative që lidhen me organizimin dhe funksionimin e seancave të KAS.

Në funksion të forcimit të standardeve të integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale, vlerësohet e nevojshme plotësimi i Rregullores për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit Ankimeve dhe Sanksioneve me dispozita që rregullojnë në mënyrë të shprehur parimin e paanshmërisë së anëtarëve, trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe publikimin e vendimeve të KAS.

Shtesat e propozuara synojnë të forcojnë garancitë për ushtrimin e pavarur dhe objektiv të funksioneve të anëtarëve të KAS, të sigurojnë transparencë në procesin vendimmarrës përmes deklarimit dhe administrimit të konflikteve të interesit dhe publikimin e vendimeve të KAS.

Konkretisht, projektakti parashikon:

- shtimin e një dispozite që përcakton detyrimin e anëtarëve të KAS për të ushtruar funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe objektive;
- shtimin e rregullave për deklarimin dhe administrimin e konfliktit të interesit gjatë shqyrtimit dhe vendimmarrjes;
- publikimin e vendimeve të KAS

Rruga “Ibrahim Rugova”. Nr.4, Tiranë, Shqipëri



Rruga “Ibrahim Rugova”. Nr.4, Tiranë, Shqipëri

- Nisur nga sa më sipër dhe në përputhje me nenin 16 të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator, paraqesim për shqyrtim projektvendimin ““Për disa shtesa në vendimin nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, ‘Për miratimin e Rregullores për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit Ankimeve dhe Sanksioneve’, së bashku me relacionin përkatës.

Dritan ÇAKA

Anëtar i Komisionit Rregullator




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më
Nr.

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.3, DATË 06.11.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE ZHVILLIMIT TË SEANCAVE TË KOMISIONIT ANKIMEVE DHE SANKSIONEVE", I NDRYSHUAR

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni Rregullator është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ që lidhen me organizimin dhe funksionimin e KAS.

Neni 20, pika 1, shkronja "d" e Kodit Zgjedhor parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e Rregullores së seancave të KAS.

Në përputhje me nenin 16 të Rregullores, paraqitet për shqyrtim projektvendimi "Për disa shtesa në vendimin nr.3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e Rregullores për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit Ankimeve dhe Sanksioneve".

Dispozitat e propozuara janë në përputhje me parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, paanshmërisë së organeve publike, transparencës dhe integritetit në ushtrimin e funksioneve publike, si dhe harmonizohen me legjislacionin në fuqi që rregullon konfliktin e interesit dhe ushtrimin e funksioneve publike.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Me vendimin nr.3, datë 06.11.2020, Komisioni Rregullator ka miratuar Rregulloren për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit Ankimeve dhe Sanksioneve.

Gjatë zbatimit të kësaj rregulloreje është evidentuar nevoja për plotësimin e saj me dispozita të posaçme që forcojnë standardet e paanshmërisë së anëtarëve të KAS, rregullojnë mënyrën e trajtimit të rasteve të konfliktit të interesit dhe publikimin e vendimeve të miratuara prej tij.

Projektvendimi ka karakter normativ dhe propozon shtimin e katër dispozitave të reja në rregullore.

1. Shtohet një nen i ri "Paanshmëria e anëtarit të KAS".

Kjo dispozitë përcakton detyrimin e çdo anëtarit të KAS për të ushtruar funksionin në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe në përputhje me Kushtetutën, Kodin Zgjedhor dhe legjislacionin në fuqi. Gjithashtu ndalohet favorizimi ose diskriminimi i palëve gjatë procesit të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe parashikohet detyrimi për shmangien e çdo veprimi apo sjelljeje që mund të krijojë dyshime të arsyeshme mbi paanshmërinë dhe objektivitetin e anëtarit.

Paanshmëria e anëtarit të KAS

1. Çdo anëtar i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) ushtron detyrën e tij në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe në përputhje me Kushtetutën, Kodin Zgjedhor dhe legjislacionin në fuqi.
2. Gjatë shqyrtimit dhe vendimmarrjes për çdo çështje, anëtarët e KAS nuk mund të favorizojnë ose të diskriminojnë asnjë palë për arsye personale, politike, ekonomike, financiare ose për çdo shkak tjetër që cenon paanshmërinë e tyre.
3. Anëtarët e KAS janë të detyruar të shmangin çdo veprim ose sjellje që mund të krijojë dyshime të arsyeshme mbi paanshmërinë dhe objektivitetin e tyre në ushtrimin e detyrës.

2. Shtohet një nen i ri “Konflikti i Interesit”.

Kjo dispozitë përcakton detyrimin e anëtarit të KAS, për deklarimin e menjëhershëm të çdo konflikti interesi real ose të mundshëm përpara shqyrtimit të çështjes përkatëse. Gjithashtu parashikohet mospjesëmarrja e anëtarit në diskutim dhe vendimmarrje në rast konflikti interesi, si dhe regjistrimi i këtij fakti në procesverbalin e seancës.

Konflikti i Interesit

1. Çdo anëtar është i detyruar të njoftojë menjëherë relatorin e çështjes për çdo situatë që mund të konsiderohet konflikt interesi.
2. Anëtarit që ka deklaruar konflikt interesi nuk merr pjesë në diskutimin, shqyrtimin apo vendimmarrjen që lidhet me çështjen për të cilën ekziston konflikti i interesit.
3. Përgjashtimi dokumentohet me shkrim dhe regjistrohet në dosjen administrative të çështjes.

3. Shtohet një nen i ri “Publikimi i Vendimeve”

Publikimi i vendimeve

1. Të gjitha vendimet e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) publikohen në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).
2. Publikimi i vendimeve kryhet në format elektronik, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e transparencës së KQZ-së.

Projektvendimi nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nuk kërkon ndryshime në strukturën organizative të institucionit.

Për sa më sipër, propozohet miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa në vendimin nr.3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e Rregullores për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit Ankimeve dhe Sanksioneve”.

Dritan ÇAKA

Anëtar i Komisionit Rregullator



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: .6.2026

Nr:

Ora: 00:00

PROJEKTVENDIM

PËR

DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.3, DATË 06.11.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE ZHVILLIMIT TË SEANCAVE TË KOMISIONIT ANKIMEVE DHE SANKSIONEVE", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 12, pika 4, dhe nenit 20, pika 1, shkronja "d", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e një anëtari, Komisioni Rregullator;

V E N D O S I:

I. Në vendimin nr.3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Pas nenit 51 shtohet neni 51/1 me këtë përmbajtje:

Neni 51/1

Paanshmëria e anëtarit të KAS

1. Çdo anëtar i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) ushtron detyrën e tij në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe në përputhje me Kushtetutën, Kodin Zgjedhor dhe legjislacionin në fuqi.
2. Gjatë shqyrtimit dhe vendimmarrjes për çdo çështje, anëtarët e KAS nuk mund të favorizojnë ose të diskriminojnë asnjë palë për arsye personale, politike, ekonomike, financiare ose për çdo shkak tjetër që cenon paanshmërinë e tyre.
3. Anëtarët e KAS janë të detyruar të shmangin çdo veprim ose sjellje që mund të krijojë dyshime të arsyeshme mbi paanshmërinë dhe objektivitetin e tyre në ushtrimin e detyrës.

2. Pas nenit 51/1 shtohet neni 51/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 51/2

Konflikti i Interesit

1. Çdo anëtar është i detyruar të njoftojë menjëherë relatorin e çështjes për çdo situatë që mund të konsiderohet konflikt interesi.
2. Anëtari që ka deklaruar konflikt interesi nuk merr pjesë në diskutimin, shqyrtimin apo

Data: .___.2026 Nr:
Ora:



Për disa shtesa në vendimin nr.3, datë
06.11.2020, të Komisionit Rregullator

vendimmarrjen që lidhet me çështjen për të cilën ekziston konflikti i interesit.

3. Mospjesëmarrja dokumentohet me shkrim dhe regjistrohet në dosjen administrative të çështjes.
3. Pas nenit 51/2 shtohet neni 51/3 me këtë përmbajtje:

Neni 51/3

Publikimi i vendimeve

1. Të gjitha vendimet e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) publikohen në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).
 2. Publikimi i vendimeve kryhet në format elektronik, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e transparencës së KQZ-së.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- III. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 30 ditëve.

Kryetar
Ilirjana NANO

Anëtar
Arben RISTANI

Anëtar
Bledar SKËNDERI

Anëtar
Dritan ÇAKA

Anëtar
Helga VUKAJ

Data: __.2026 Nr:
Ora:



Për disa shtesa në vendimin nr.3, datë
06.11.2020, të Komisionit Rregullator